



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr 060 - 24.08.22
Klinë, dt: 18.07.22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 13.6.2022, me fillim nga ora 9:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, drejtoret dhe të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së. Përveç pikave të parapara për shqyrtim në rendin e ditës, pikë shtesë hyri edhe kërkesa nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për Ri-alokim të mjeteve rezervë.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025 (ref. Drejt. Financave),
4. Shqyrtimi i propozimit për lirim nga qiraja komunale për vitin 2020 dhe 2021 kategoritë e dala nga lufta dhe banuesit social (ref. Drejt. Financave),
5. Shqyrtimi i kërkesave te arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Maj-Qershor 2022,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës, bashkë me kërkesën e parashtruar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 6 vota PËR, u miratua rendi i ditës, së

bashku me kërkësën e parashtuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, Kryesues: Po konstatoj se prezent për momentin jemi gjashtë anëtarë te komitetit, përveç anëtares, Mendehie Duraku, e cila ka një rast dhe do të na bashkohet më vonë.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, Kryesues: Nëse ka dikush diçka rrëth procesverbalit nga seanca e kaluar, urdhëroni!

Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 6 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

Fadil Gashi, Kryesues: Kemi ushtruesin e detyrës së drejtorit, z. Ajet Sejdiu, nëse dëshiron një prezantim. Vetëm ta keni parasysh se na ka ardhur një muaj me vonësë nga Qeveria, jemi vonë, sepse pa na ardhur nga qarkorja ne s'mund të fillojmë. Unë kisha dashur mirëkuptimin e komitetit me rekomandu ne si komitet me lëshu në diskutim publik dhe unë ju kisha ftuar të gjithë anëtarëve të komitetit me dal ne teren, të merrni pjesë aty ku organizohen nëpër fshatra dhe mjedise të ndryshme, tash ne do ta shohim si janë mundësitë e organizimit. Një e mirë tjetër është që ne e ngritim shkallën e performancës edhe si kuvend sepse ju e dini, për çdo aktivitet që e zhvillon kuvendi, ne marrim poena. Po e kundërtë është se, nëse mbesim mbrapa, ne marrim pikë negative dhe s'mund të jemi përfitues. Unë po hapi debat!

Tunë Dedaj: Përvendetje Kryesues për ju dhe për të gjithë të pranishmit. Po, unë pajtohem me propozimin e juaj që ky të shkojë në diskutim publik menjëherë dhe mos ta vonojmë, por në rast që nuk mund të arrijmë deri në seancë për t'i realizuar gjitha ato procedura çka parashihen, atëherë është mirë për ta paraparë një seancë të jashtëzakonshme, por nëse mundemi, atëherë e kryejmë në seancën e rregullt.

Ajet Sejdiu: Përvendetje Kryesues, përvendetje edhe për ju anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Drejtoria e Financave momentin e arritjes së qarkores 1/2023 ju ka vënë punës duke i njoftuar të gjithë faktorët relevant që bëjnë pjesë në realizimin e kësaj qarkore, në bazë të kufijve që ja ka caktuar granti qeveritar dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. E tha kryetari i kuvendit që është vonuar në këtë vit jashtëzakonisht shumë, jemi bukur mbrapa por kemi arritur ta përpunojmë qarkoren dhe ti përcaktojmë kufijtë buxhetorë, ashtu siç i keni ju sot përpara. Afati ligjor për aprovim të kornizës afatmesme buxhetore 2023-2025 është 30 qershorë.

Me 6 vota PËR, u rekomandua që korniza afatmesme buxhetore 2023-2025, të dal në diskutim publik dhe pas shqyrtimit me publikun, të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

4. Shqyrtimi i propozimit për lirim nga qiraja komunale për vitin 2020 dhe 2021 kategoritë e dala nga lufta dhe banuesit social (ref.Drejt. Financave).

Kryesuesi i dha fjalën ushtruesit të detyrës së drejtorit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Ajet Sejdiu.

Ajet Sejdiu: Duke u bazuar në kërkesat e këtyre kategorive permanente sistematike, me shkrim dhe me gojë, po ashtu edhe gjendjes ekonomike që ka ekzistuar, Bordi i Drejtorëve, më 23.05.2022 ka marr vendim që ta autorizojë Drejtorinë e Financave që t'i bëjë një kërkesë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit, që këto kategori të lironen për dy vite nga qiratë. Është e drejtë ligjore e kuvendit e askujt tjetër me e marr një vendim të tillë, situatën ekonomike po e shihni ju vetë, ka borxhe të grumbulluara shumë, veç e keni parë sa janë. Ka njerëz shumë të rrallë që i kanë kryer obligimet e qerasë në bazë të marrëveshjeve valide që i kanë pasur me Komunën, por ata që i kanë kryer dalin në parapagim kështu që mos me ju mohu e drejta asnjë kategorie nëse merret ky vendim.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit, Ajet! Unë po e shprehi mendimin tim personal, nuk jua preferoj as komitetit dhe as kuvendit për të fal, sepse nuk i kane kushtet për t'i fal. Po e shoh se borxhet janë jashtëzakonisht të mëdha. Nëse nuk ju bëhet vonë, me prit edhe komisionin që është duke punuar edhe me shiku me nxjerr një pasqyrë reale se çfarë është duke u bërë me pronën e komunës. Urdhëro, Tunë Dedaj!

Tunë Dedaj: Po Kryesues, këtë radhë është mendimi im personal, jo i subjektit tim politik. Në radhë të parë po e shoh si gabim të Bordit të Drejtorëve të marrin këso vendime dhe të ju drejtohen Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, se aty duhet me pa me të vërtetë, ai që është rast social e që nuk ka të ardhura përpos socialit është mirë të lirohet. Por ka se i kanë të punësuar një ose dy, por ka edhe se janë jashtë vendit. Kjo është neglizhencë dhe është dashtë me paraparë ata që e kanë dikë të punësuar nuk duhet me ju fal por duhet me u angazhuar me përmbarues me ja marr mjetet, e ata që janë vërtetë social, me i liru.

Bledar Berisha: Përshëndetje Kryesues, përshëndetje për gjithë, kam një pyetje për ushtruesin e detyrës së drejtorit, Z. Ajet Sejdiu. Këtu te përfituesit e mëhershëm të objektit të banimit të komunave, Sokol Bashota dhe Enver Berisha, edhe pse kanë qenë përfitues te mëhershëm të këtyre banesave, po tash këta i kanë dhanë dhe nuk kanë të drejtë dhe detyrime për këto banesa, nuk e di pse figuron emri i tyre ende, a jeton dikush në to apo paguan dikush qira?

Ajet Sejdiu: Po, është e vërtetë që figurojnë emrat e këtyre dy ish-shfrytëzuesve por me ligjin mbi kontabilitetin, shënimet kurrë nuk hiqen nga evidenca, ato duhet të mbeten, kështu që 0:0 e kanë gjendjen financiare, ndoshta e shihni përrpara, por nuk guxojmë në aspektin ligjor me i shlye prej kontabiliteti.

Me 6 vota PËR, Komiteti rekomandoi që paraprakisht të bëhet një vlerësim i gjendjes ekonomike për secilin nga këta banues dhe pastaj të shqyrtohet në kuvend propozimi për lirim nga qiraja.

Pika 5. Shqyrtimi i kérkesave te arritura pér Komitetin pér Politikë dhe Financa pér muajin Maj-Qershор 2022.

Kérkesa 1.

Kérkesë e parashtruar nga Mejreme Itaj nga fshati Klinafe, Komuna Klinë, shfrytëzuese e njësisë kadastrale Nr. 00747-0 ZK Klinafe, në sipërfaqe prej 4632 m² dhe pjesën e njësisë kadastrale nr. 00740-0 ZK Klinafe, të cilat janë të evidentuara në emër të Komunës së Klinës, po në këto dy pjesë ka të ndërtuar shtëpi dhe disa objekte përcjellëse para shumë vitesh. Pas shpalljes së ankandit nga ana e komunës kérkon që të marrë në shfrytëzim pér 99 vite me taks ashtu siç e parasheh komuna.

Fadil Gashi, Kryesues: Ju e dini se ne nuk kemi listë të shpallur si e kérkon ligji pér dhënie në shfrytëzim pér hapësira publike. Unë nuk po hyj në arsyetim sepse mund të ketë arsyetim kjo që e kérkon, por ne i kemi trajtuar njëjtë të gjitha këto kérkesa që na kanë ardhur edhe prapë kisha propozuar që njëjtë ta trajtojmë edhe këtë shkresë, sepse nuk kemi rrugë tjetër. Unë po hap debat gjithsesi, nëse ka dikush diçka, urdhëroni!

Tunë Dedaj: Edhe unë pajtohem me ju, Kryesues, që sikur kérkesat tjera që i kemi pasur më pérpara, të shkojë edhe kjo në organe kompetente pér ta shqyrtuar këtë lëndë, ky është mendimi im.

Me 6 vota PËR, Komiteti pér Politikë dhe Financa, rekomandoi që kjo kérkesë të kalojë pér shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe pastaj të vijë në Kuvend.

Kérkesa 2.

Kérkesë e parashtruar nga Lirie Gashi, anëtar e Kuvendit të Komunës, e cila kérkon që të sigurohet transporti pér nxënësit e fshatit Dollci pa pagesë ose 50% më lirë. Kérkesa parashtrohet duke marrë parasysh gjendjen ekonomike e cila është e rënduar.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë e kam ftuar komisionin dhe besoj se ata janë duke punuar. Le t'na sjellin edhe këtë raport se cilat shkolla e bëjnë bartjen e nxënësve, si bëhet bartja dhe le ta merr komisioni në shqyrtim.

Tunë Dedaj: Po Kryesues, unë e pash me vëmendje dhe ja lexova emrat, po edhe kjo është e rregulluar në bazë të Ministrisë së Arsimit, në bazë të kilometrave e unë s'besoj që Dollci i ka mbi 4 kilometra e gjysmë udhëtim, këtu do të ishte mirë të mendojë komuna, se Dollci tash është bërë fshat bukur i madh, do të ishte mirë me e nda aty një paralele të shkollës, me e hap në Dollci edhe mos me ju bërë ngarkesë me i bartë fëmijët nëpër qytet.

Me 6 vota PËR, Komiteti rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në DKA dhe në komision, i cili është themeluar nga Kuvendi .

Kërkesa 3. Për marrjen e vendimit për Ri-alokimin e mjeteve rezervë.

Ajet Sejdiu: Ne e kemi bërë këtë kërkesë pas konsultimit që kemi bërë me Ministrinë e Financave. Kërkesën e keni përpara por nëse keni dëshirë unë ju lexoj, vetëm na është preferuar nga Ministria që projektet të emërtohen, psh., kanalizmi në fshatrat Bokshi q ose Qeskovë, se asnjë projekt nuk po e pranon Ministria pa u emërtuar edhe me emër.

Fadil Gashi, Kryesues: Unë po kërkoj me rekomanduar për Kuvend dhe po hapi debat. Nëse ka dikush ,urdhëroni?

Me 6 vota PËR, u rekomandua që kërkesa për ri-alokim të mjeteve të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Pika 6. Të ndryshme.

Fadil Gashi, Kryesues: Të ndryshme, a ka dikush? Nëse jo, e deklaroj mbledhjen e mbyllur duke ju falënderuar shumë për pjesëmarrje dhe për angazhim.

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

[Handwritten signature]



K R Y E S U E S I,
Fadil Gashi

[Handwritten signature]